



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 39, datë 21.05.2024



PËR KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 160, DATË 18.10.2023, PËR KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS “PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. ALTIN XHAFI, NR. 36, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. PETRIT HAJRO, NR. 32, DATË 26.03.2021 PËRSA I PËRKET Z. LIRIM IBRAHIMI, NR. 67, DATË 17.03.2023 PËRSA I PËRKET Z. QANI XHABLI DHE Z. XHEVAHIR XHABLI, NR. 37, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. PANDELI SHTËMBARI, Z. THOMA SHTËMBARI, ZNJ. VIOLETA SHTËMBARI DHE ZNJ. ADRIANA SHTËMBARI, NR. 77, DATË 28.06.2021 PËRSA I PËRKET Z. RUSTEM GJERGJI”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 160, datë 18.10.2023 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimet e Këshillit Bashkiak nr.71, datë 20.07.2020 për shtesave të Altin Xhafa, nr. 36, datë 09.05.2022 për shtesave të Petrit Hajro, nr. 32, datë 26.03.2021 për shtesave të Lirim Ibrahim, nr. 67, datë 17.03.2023 për shtesave të z. Qani Xhabli dhe z. Xhevahir Xhabli, nr. 37, datë 09.05.2022 për shtesave të Pandeli Shtëmbari, z. Thoma Shtëmbari, znj. Violeta Shtëmbari dhe znj. Adriana Shtëmbari, nr. 77, datë 28.06.2021

përsa i përket z. Rustem Gjergji”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një korigjimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 160, datë 18.10.2023, përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Petrit Hajro në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 2+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçmë e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 328/prot.
4

Durrës, më 29.05.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

BASHKIA DURRESE
29.05.24 Nr. 5942/B

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.39 datë 21.05.2024 “Për korigjim gabimi material në Vendimin nr 160, datë 18.10.2023 të Këshillit Bashkiak Durrës “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimet e Këshillit Bashkiak nr 71 datë 20.07.2020 përsa i përket Z.Altin Xhafa nr 36 datë 09.05.2022, përsa i përket Z.Petrit Hajro nr 32 dt 26.03.2021, përsa i përket Z.Lirim Ibrahimimi nr 67 dt 17.03.2023, përsa i përket z.Qani Xhabli dhe Z.Xhevahir Xhabli nr 37 dt 09.05.2022, përsa i përket Z.Pandeli Shtëmbari, Z.Thoma Shtëmbari, Znj. Violeta Shtëmbari dhe Znj. Adriana Shtëmbari nr 77 dt 28.06.2021, përsa i përket Z. Rustem Gjergji”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI